



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike
/e plotësuar dhe ndryshuar/

Prill 2022

Përmbajtja

Kapitulli I	Dispozita të përgjithshme	3
Neni 1	Fushëveprimi dhe Qëllimi	3
Neni 2	Përkufizimet dhe Interpretimet	4
Kapitulli II	Rregullimi i të Hyrave dhe Tarifave	5
Neni 3	Parime të përgjithshme	5
Neni 4	Procedura e aplikimit dhe e miratimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Tarifave	6
Neni 5	Apelimi	7
Kapitulli III	Të Hyrat e Lejuara Maksimale	7
Neni 6	Parime të përgjithshme	7
Neni 7	Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes	8
Neni 8	Zhvlerësimi i lejuar	9
Neni 9	Kthimi i lejuar në asete	9
Neni 10	Humbjet e lejuara në rrjet	10
Neni 11	Mekanizmi i përshtatjes	11
Neni 12	Kostot e lejuara variabile të gjenerimit të ngrohjes	12
Neni 13	Kostot e bartura	12
Neni 14	Alokimi i kostove në komponentë fikse dhe variabile	12
Kapitulli IV	Tarifat e Energjisë Termike	13
Neni 15	Parime të përgjithshme	13
Neni 16	Struktura Tarifore dhe Faturimi	14
Kapitulli V	Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare	15
Neni 17	Publikimi	15
Neni 18	Gjuha dhe interpretimi	15
Neni 19	Ndryshimet	15
Neni 20	Shfuqizimi	15
Neni 21	Hyrja në fuqi	15

Kapitulli I
Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike (në tekstin e mëtejshëm “Rregulla”), në pajtueshmëri me Nenet 9 (1), 15, 26 (1) dhe me Kapitullin IX (Nenet 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50) të Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, vendos parimet për llogaritjen dhe aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave të rregulluara, si dhe procedurave për paraqitjen e aplikacionit, shqyrtimin, përshtatjen dhe aprovimin e tarifave dhe çmimeve të ngrohjes në sektorin e rregulluar të energjisë termike.
2. Rregulla do të zbatohet për ndërmarrjet që kanë licencë për prodhim, shpërndarje dhe furnizim të energjisë termike.
3. Rregulla përcakton:
 - a) Parimet themelore dhe metodologjinë për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale që mund të mblidhen nga ndërmarrjet e rregulluara të energjisë termike në mënyrë që t’i lejoj ato për të rikthyer kostot e arsyeshme të operimit, mirëmbajtjes dhe investimit në gjenerim dhe rrjetet me qëllim të furnizimit të konsumatorëve me ngrohje në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
 - b) Procesin me të cilin aplikacionet për këto të hyra të lejuara maksimale duhet të dorëzohen, shqyrtohen dhe aprovohen; dhe
 - c) Procesin dhe metodologjinë me të cilën përcaktohen tarifat e ngrohjes, përmes së cilave mblidhen të hyrat e lejuara maksimale.
4. Parimet dhe metodologjitë e përshkruara në këtë Rregull sigurojnë:
 - a) kryerjen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese të aktiviteteve të rregulluara të energjisë termike të cilat u nënshtrohen detyrimeve të shërbimit publik;
 - b) që interesat ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë termike të jenë të balancuara si duhet;
 - c) kushte të qëndrueshme dhe të parashikueshme për operimin e ndërmarrjes gjatë kryerjes së aktiviteteve të rregulluara;
 - d) që tarifat për aktivitetet e rregulluara të energjisë termike janë llogaritur në mënyrë të arsyeshme, objektive dhe të qartë;
 - e) furnizim të sigurt me ngrohje përmes mirëmbajtjes dhe ndërtimit të kapaciteteve të nevojshme të gjenerimit dhe distribucionit;
 - f) Mbrojtjen e konsumatorëve përmes promovimit të qasjes transparente dhe të hapur në informacionet që kanë të bëjnë me përfshirjen në konsultime publike dhe vendimmarrje për tarifat e ngrohjes.

Neni 2 Përkufizimet dhe Interpretimet

Termet e përdorura në këtë Rregull duhet të kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë Termike.

“Të hyra të rregulluara aktuale” të hyrat e mbledhura nga një ndërmarrje e rregulluar përmes tarifave për ofrimin e ngrohjes së matur në baza akruale.

“Mekanizmi i Përshtatjes” mekanizmi i aplikuar për përshtatjen e rregullt të të hyrave të lejuara maksimale. Përshtatja bëhet çdo vit pas secilës periudhë rregullative respektivisht para shqyrtimit të ardhshëm tarifor, siç është përshkruar në nenin 11.

“Zhvlerësimi i lejuar” ka kuptimin e dhënë në Nenin 8.

“Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes” kanë kuptimin e dhënë në nenin 7 të kësaj Rregulle dhe janë të përbëra nga pjesa fikse dhe pjesa variabile në përputhshmëri me dispozitat e të njëjtit nen.

“Kthimi i lejuar në bazën e rregulluar të aseteve” është definuar në Nenin 9 dhe është i barabartë me Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC – “Weighted Average of Cost of Capital”).

“Shqyrtim vjetor”- proces i kryer nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të shqyrtuar të dhënat e ofruara nga ndërmarrjet e rregulluara dhe për të vendosur të hyrat e lejuara maksimale.

“Borxhi i keq i lejuar” – kosto e arsyeshme e lejuar nga ZRRE për zvogëlimin në të hyra të shkaktuar nga pamundësia e arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, që është definuar më tutje në nenin 11, paragrafi 5.

“Rrjeti i Shpërndarjes” - rrjeti i energjisë termike për transportimin e energjisë termike nga impiantet e gjenerimit tek konsumatorët.

“Jetëgjatësia e aseteve”- jetëgjatësia e aseteve e përdorur për të llogaritur zhvlerësimin e lejuar në bazën e rregulluar të aseteve.

“Kosto fikse”- kosto që nuk ndryshojnë me vëllimin e ngrohjes së furnizuar nga sistemi i energjisë termike dhe në këtë mënyrë konsiderohen të jenë fikse.

“Të hyra të parashikuara” – të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale të përcaktuara para fillimit të secilës periudhë rregullative që janë planifikuar për tu rikthyer përmes tarifave duke supozuar kostot e parashikuara dhe furnizimin me ngrohje.

“Sezoni i ngrohjes”- periudha e furnizimit me ngrohje qendrore e cila fillon me 15 Tetor të vitit aktual deri me 15 Prill të vitit të ardhshëm nëse nuk zgjatet apo shkurtohet në përputhje me nenin 6 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji te nxjerrë nga ZRRE.

“Plani Zbatues dhe Orari”- dokument shoqëruar i kësaj Rregulle i përgatitur dhe publikuar nga ZRRE para periudhës rregullative. 5

“Të Hyra të Lejuara Maksimale” (MAR – “Maximal Allowed Revenues”) – shuma maksimale që mund të rikthehet gjatë periudhës rregullative nga ndërmarrja e rregulluar e ngrohjes qendrore përmes tarifave të saj, formulat e dhëna në Shtojcën 1 të kësaj rregulle

“Me matje” nënkupton me çdo sasi të matur të energjisë termike (ngrohjes) nga një matës i instaluar për këtë qëllim”

“Kostot e bartura”- kostot e vendosura në pajtueshmëri me nenin 13

“Norma e kthimit”- metodë për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale duke shtuar një normë specifike të kthimit e aplikuar në bazën e rregulluar të aseteve tek kostot e lejuara të ndërmarrjes së rregulluar.

“Baza e rregulluar e aseteve”- vlera rregullative e aseteve fikse të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, të konsideruara për t’u përdorur dhe që janë të dobishme për furnizimin e energjisë termike, e përcaktuar siç është përshkruar në Shtojcën 2.

“Periudhë rregullative” – periudha që përfshinë sezonin e ngrohjes në pajtueshmëri me përkufizimin e dhënë në nenin 3.

“Rrjeti i Transportimit” përfshin tubacionet e ndërtuara në mënyrë specifike për të lidhur një impiant të ko-gjenerimit apo impiant tjetër në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.

“Kostot variabile” janë kostot që ndryshojnë me vëllimin e ngrohjes së furnizuar nga sistemi i energjisë termike dhe si të tilla konsiderohen të jenë variabile.

“ZRRE” – Zyra e Rregullatorit për Energji.

“Ndërtesë me shumë njësi” - Për qëllime të Metodologjisë në Shtojcën ‘8’, ‘ndërtesa me shumë njësi’ ka kuptimin e: i) një ndërtesë të banimit kolektiv me 2 e më shumë apartamente, secili në pronësi të një individi (personi) i cili në të njëjtën kohë është klient i ngrohjes qendrore; dhe/ose ii) një ndërtesë me shumë lokale afariste, secili në pronësi të një individi (personi), i cili në të njëjtën kohë është klient i ngrohjes qendrore; dhe/ose iii) kombinimi i të dyjave – e ashtuquajtura “ndërtesë me shumë qëllime” – që përbëhet nga shumë apartamente dhe lokale afariste. Analogjikisht ‘njësia’ ka kuptimin e një apartamenti dhe/ose lokali afarist.

“Matje në nivel nënstacioni” – nënkupton matjen e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) me pajisje matëse adekuate të instaluar dhe funksionale në nënstacionin termik në një ndërtesë të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore.

“Matje në nivel njësie” – nënkupton matjen e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) të një njësie (banesë ose lokal afarist) në një ‘ndërtesë me shumë njësi’, përmes pajisjeve matëse adekuate (alokatorët ose matësit individual të ngrohjes).

Kapitulli II **Rregullimi i të Hyrave dhe Tarifave**

Neni 3 **Parime të Përgjithshme**

1. Të hyrat e lejuara maksimale të ndërmarrjeve të rregulluara të energjisë termike si dhe tarifat e konsumatorëve do të caktohen përmes procesit të shqyrtimeve tarifore vjetore të përshkruar në këtë Rregull.
2. Çdo Shqyrtim vjetor do të do të ketë kohëzgjatje prej një viti, duke filluar nga 15 tetori i vitit aktual deri në 14 tetorin e vitit të ardhshëm, ashtu që të përfshijë sezonin e ngrohjes i cili zgjatë nga 15 tetori deri me 15 prill të vitit të ardhshëm kalendarik.

3. Para çdo Shqyrtimi vjetor, ZRRE mund të vendos të aplikohen tarifat shumëvjeçare, dhe përmes procesit të konsultimeve publike ZRRE përcakton edhe kohëzgjatjen e periudhës rregullative. Nëse periudha rregullative nuk përcaktohet nga ZRRE, atëherë kohëzgjatja e periudhës rregullative është e njëjtë me kohëzgjatjen e Shqyrtimit vjetor.
4. Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale janë dhënë në Shtojcën 1 ndërsa parimet për përcaktimin e tarifave të konsumatorëve janë dhënë në kapitullin IV.
5. Për çdo ndryshim në çmime për prodhim, shpërndarje dhe furnizim të energjisë termike, ZRRE do të bëjë konsultim publik, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Neni 27.

Neni 4

Procedura për Aplikim dhe Aprovim të të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Tarifave

1. Duke respektuar afatin e përcaktuar në Planin Zbatues dhe Orarin, i përgatitur dhe publikuar nga ZRRE para Shqyrtimit vjetor, ndërmarrja e energjisë termike i paraqet ZRRE-së një aplikacion me shkrim për aprovim të të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave përkatëse të energjisë termike (ngrohjes) për periudhën e ardhshme rregullative.
2. Aplikacioni duhet të përmbaj një propozim për të hyrat e lejuara maksimale për ngrohjen e dërguar tek konsumatorët fundor si dhe dokumentet shoqëruese siç është përcaktuar në Shtojcën 4.
3. ZRRE do të verifikoj dhe ekzaminoj të gjitha të dhënat dhe informatat që përmban aplikacioni dhe të kryej shqyrtimin vjetor në pajtueshmëri me procesin e përcaktuar në Shtojcën 5.
4. Pas pranimit të aplikacionit nga ndërmarrja e energjisë termike për aprovim të të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave, ZRRE duhet të publikoj të gjitha dokumentet relevante qoftë të nxjerra nga ajo si dhe ato të ndërmarrjeve në fjalë (duke përjashtuar informatat konfidenciale) dhe duhet të publikoj çdo draft-rregull tjetër, draft-akt individual apo draft-vendim. Gjithashtu, ZRRE duhet të takohet me ndërmarrjet e licencuara të energjisë termike për të diskutuar dokumentet e dorëzuara apo çfarëdo çështje të ndërlidhur me aplikim, si dhe të mbaj konsultim publik.
5. Bazuar në verifikim dhe ekzaminimin e aplikacionit dhe pas periudhës së konsultimit të përcaktuar në Planin Zbatues dhe Orarin, ZRRE do të:
 - a) aprovoj të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifat ashtu siç është propozuar nga ndërmarrja e energjisë termike nëse këto janë në pajtueshmëri me parimet e llogaritjes së të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave siç është përcaktuar në këtë Rregull; apo
 - b) refuzoj aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave të propozuara nga ndërmarrja e energjisë termike dhe në vend të kësaj të llogaris dhe përcaktoj të hyrat e lejuara dhe tarifat për periudhën rregullative, bazuar në parimet e përcaktuara në këtë Rregull.
6. ZRRE do të refuzoj aprovimin e tarifave të propozuara, nëse ato nuk janë në pajtueshmëri me parimet e llogaritjes së tarifave siç është përcaktuar në Kapitullin IV të kësaj Rregulle. Refuzimi duhet të arsyetohet në formë të shkruar dhe duhet të jetë objektiv, jo-diskriminues dhe i arsyetuar në mënyrë të rregullt.

7. ZRRE do t'i komunikoj me shkrim ndërmarrjes së energjisë termike vlerën e të hyrave të lejuara maksimale të saj dhe të tarifave çdo vit, brenda një kornize të caktuar kohore të përcaktuar në Planin Zbatues dhe Orarin. Përcaktimi i të hyrave të lejuara do të shoqërohet me shtojcën-raportin rregullativ me sqarim analitik mbi metodologjinë e përcaktimit të të hyrave të lejuara, si dhe një justifikim i plotë i një përcaktimi të tillë.
8. Vendimi për tarifën, në formë të shtypur, duhet të dërgohet tek aplikanti apo përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe duhet të publikohet (pa shtojcën e përmendur në paragrafin 7) në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së para fillimit të sezonit të ngrohjes.

Neni 5 Apelimi

1. Ndërmarrjet e energjisë termike kanë të drejtën të apelojnë në gjykatën kompetente të juridiksionit në lidhje me përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe vendimin e aprovimit të tarifave.
2. Apelimi duhet të përfshij justifikim të plotë të bazës së tij.
3. Apelimi i referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, mund të paraqitet në gjykatën kompetente të juridiksionit brenda 30 ditëve nga data e pranimit të vendimit final për aprovimin e tarifave.
4. Apelimi nuk do të parandaloj zbatimin lidhur me përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe vendimin për aprovim të tarifave, në pajtueshmëri me Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Kapitulli III Të Hyrat e Lejuara Maksimale

Neni 6 Parime të Përgjithshme

1. Të hyrat e lejuara maksimale janë kufiri më i lartë i të hyrave që i lejohen ndërmarrjes së energjisë termike t'i realizoj brenda periudhës rregullative.
2. Të Hyrat maksimale të lejuara do të përcaktohen bazuar në Metodologjinë tarifore të aprovuar nga ZRRE.
3. Në pajtueshmëri më parimet e Metodologjisë tarifore, të hyrat e lejuara duhet t'i mundësojnë ndërmarrjes së energjisë termike të rikthejë kostot e arsyeshme të justifikuara, të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të rregulluara.
4. Të hyrat e lejuara maksimale përbëhen nga:
 - a) Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (Neni 7);
 - b) Zhvlerësimi i lejuar (Neni 8);
 - c) Kthimi i lejuar në bazën e rregulluar të aseteve (Neni 9);
 - d) Kostoja e lejuar e humbjeve (për aktivitetin e Shpërndarjes Neni 10); dhe
 - e) Përshtatja (Neni 11).

5. Gjatë përcaktimit të kostove të arsyeshme, Zyra e Rregullatorit për Energji duhet t'u referohet, në mes tjerash, por të mos jetë e kufizuar vetëm në:
 - a) Informatat dhe të dhënat ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e rregulluar të energjisë termike;
 - b) Parashikimit rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e rregulluar të energjisë termike.
 - c) Krahasimet me ndërmarrjet dhe aktivitetet e ngjashme në Kosovë dhe shtetet tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë ndërmjet sektorit të energjisë termike të atyre vendeve dhe atij të Kosovës.
6. Kostot që rezultojnë të arsyeshme duhet të alokohen ndërmjet kostove fikse dhe kostove variabile, ashtu që kostot fikse të mbulohen nga tarifat e kapacitetit dhe ato variabile nga tarifat e energjisë siç është përshkruar në Nenin 14.

Neni 7

Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes

1. Në dorëzimin e vlerësimeve të saj për kostot operative dhe të mirëmbajtjes të kërkuara për t'u rikthyer përmes të hyrave të lejuara maksimale për secilën periudhë të ardhshme rregullative, ndërmarrja e rregulluar duhet të kërkoj vetëm rikthimin e kostove që mund t'i atribuohen në mënyrë të arsyeshme aktivitetit të rregulluar të energjisë termike.
2. Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes duhet të përfshijnë kostot përkatëse të aktiviteteve të gjenerimit dhe shpërndarjes e furnizimit. Kostot e përbashkëta duhet të ndahen në gjenerim dhe shpërndarje e furnizim duke përdorur praktika të zakonshme të kontabilitetit.
3. Kostot e lejuara të operimit do të përfshijnë edhe koston e borxhit të keq i cili do të llogaritet duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Niveli i lejuar i borxhit të keq do të jetë një vlerësim i përafërt i nivelit të arsyeshëm të borxheve të këqija që mund ta ketë ndërmarrja. Niveli i lejuar i Borxhit të keq përcaktohet nga ZRRE gjatë secilit shqyrtim.
4. Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes përbëhen nga pjesa fikse dhe pjesa variabile.
5. Pjesa fikse e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes përbëhet nga:
 - a) Riparimet dhe mirëmbajtja;
 - b) Materialet dhe shërbimet;
 - c) Shpenzimet administrative;
 - d) Kostot e stafit;
 - e) Shpenzimet e shitjes dhe të tjera administrative; dhe
 - f) Komponentën fikse të pagesave për blerje të jashtme të energjisë termike dhe kostot të tjera fikse, nëse janë të aplikueshme.

6. Pjesa variabile e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes përkufizohet si ato kosto të cilat ndryshojnë me njësitë e prodhuara/ të furnizuara dhe nuk do të shkakttoheshin nëse njësitë e prodhuara/të furnizuara do të ishin zero.
7. Pjesa variabile e kostove të lejuara të operimit të aktivitetit të gjenerimit përmban komponentët në vijim: (llogaritja e tyre e përshkruar në Nenin 12)
 - a) kostot e gjenerimit të energjisë termike (ngrohjes);
 - b) Kostot e energjisë termike (ngrohjes) nga kogjenerimi vetanak;
 - c) Kostot e blerjeve të energjisë termike (ngrohjes) nga kogjenerimi i jashtëm dhe/ose burime të tjera të gjenerimit të energjisë termike (ngrohjes); dhe
 - d) Pagesa e taksës vjetore të licencimit (e cila përcaktohet bazuar në sasinë e prodhuar të energjisë termike në përputhje me Rregullën e taksave të nxjerrë nga ZRRE).
8. Pjesa variabile e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes të aktivitetit të gjenerimit është neto e kostove të ngrohjes për mbulimin e humbjeve në rrjet siç është përcaktuar në Nenin 10.
9. Pjesa variabile e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit përbëhet nga kostot e operimit dhe mirëmbajtjes që ndryshojnë me sasinë e ngrohjes së shpërndarë përmes rrjetit.

Neni 8 Zhvlerësimi i Lejuar

1. Kostot e lejuara të zhvlerësimit do të llogariten sipas metodës lineare si funksion i jetëgjatësisë të aseteve dhe bazës së rregulluar të aseteve për kategori të ndryshme të aseteve siç janë përshkruar në Shtojcën 2.
2. Zhvlerësimi i lejuar duhet të përfshijë zhvlerësimin e aseteve ekzistuese të rregulluara (të konsideruara për t'u përdorur dhe të dobishme për aktivitetin e rregulluar), të investimeve të reja në asete, përfshirë edhe asetet e financuara nga kontributet kapitale – grantet dhe subvencionet.

Neni 9 Kthimi i Lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve

1. Kthimi i lejuar në bazën e rregulluar të aseteve do të llogaritet si produkt i bazës së rregulluar të aseteve (siç është definuar në Shtojcën 2) dhe të normës së lejuar të kthimit.
2. Baza e rregulluar e aseteve që përdoret për llogaritjen e kthimit të lejuar paraqet vlerën e aseteve të ndërmarrjes së energjisë termike të përdorura dhe të dobishme për aktivitetin e rregulluar, duke përfshirë investimet e reja nëse janë aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe nuk përfshin asetet e financuara nga kontributet kapitale – grantet dhe subvencionet (detajet janë përshkruar në Shtojcën 2).

3. Norma e lejuar e kthimit është e barabartë me - Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) dhe e përcaktuar bazuar në Modelin e Çmimeve të Aseteve Kapitale siç është përshkruar në Shtojcën 3.
4. Norma e lejuar e kthimit e aplikuar për aktivitetin biznesor të energjisë termike përcaktohet nga ZRRE dhe mund të jetë e njëjtë për gjithë sektorin e energjisë termike në Kosovë.

Neni 10

Humbjet e Lejuara në Rrjet

1. Ndërmarrja e energjisë termike duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar humbjet e energjisë termike (ngrohjes) në rrjet në pajtueshmëri me një plan që përcakton caqet dhe masat që duhet të ndërmerren për periudhat e ardhshme rregullative si pjesë e planit zhvillimor (investiv).
2. Kostoja e lejuar e humbjeve do të përfshihet në mënyrë të qartë në të hyrat maksimale të lejuara të aktivitetit të shpërndarjes dhe do të zbritet nga pjesa variable e kostove operative dhe të mirëmbajtjes të aktivitetit të gjenerimit.
3. Lejimi i humbjeve paraqet komponentën e kostove variable të gjenerimit për të ofruar energji termike (ngrohje) që të mbulohet sasia e humbjeve në rrjet. Kostoja e lejuar e humbjeve llogaritet si herësi i sasisë së lejuar të humbjeve të rrjetit dhe sasisë së gjeneruar të energjisë termike që hyn në rrjet, e shumëzuar me totalin e kostove variable të gjenerimit. Llogaritja e kostos së humbjeve është dhënë detajisht në Aneksin 1.
4. ZRRE mund të vendos për secilën periudhë rregullative një nivel të lejuar të humbjeve në rrjet të shprehur në MWh/vit ose në përqindje.
5. Humbjet në rrjet janë shuma e humbjeve në rrjetin e transportimit dhe të shpërndarjes dhe llogariten bazuar në parimet në vijim:
 - a) Humbjet në transportim (nëse janë të aplikueshme) paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së energjisë termike (ngrohjes) që hyn në rrjetin e transportit dhe sasisë që del nga rrjeti i transportit në kufijtë mes rrjetit të transportit dhe atij të shpërndarjes.
 - b) Humbjet në shpërndarje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së energjisë termike (ngrohjes) që hyn në rrjetin e shpërndarjes (nga rrjeti i transportit apo direkt nga impiantet e gjenerimit) dhe sasisë së energjisë termike (ngrohjes) që del nga rrjeti i shpërndarjes në kufijtë ndërmjet rrjetit të shpërndarjes dhe konsumatorëve (siç është përcaktuar në Ligjin e Energjisë Termike). Sa më shumë që është e mundur, kjo e fundit duhet të jetë e bazuar në vlerat e matura të furnizimit të energjisë termike të regjistruar në nënstacione.
6. Për vendosjen e nivelit të lejuar të humbjeve në rrjet, ZRRE duhet të ketë parasysh:
 - a) nivelin aktual të humbjeve në rrjet për periudhën më të fundit rregullative (bazuar në vlerat e matura dhe të vlerësuara)
 - b) një reduktim të humbjeve që është i arsyeshëm dhe i arritshëm bazuar në planin zhvillimor (investiv) të ndërmarrjes së rregulluar;

- c) masat e efiçencës për reduktim të humbjeve të vëna nga ZRRE.
7. Niveli i lejuar i humbjeve në rrjet duhet të jetë i përcaktuar ashtu që të inkurajoj ndërmarrjen e rregulluar të energjisë termike që të reduktoj humbjet, por pa e rrezikuar pozitën e saj financiare.
 8. Metoda për matjen dhe vendosjen e nivelit aktual të humbjeve në rrjet mund të rishikohet para secilës periudhë rregullative. Përputhshmëria me metodologjinë e përshkruar në paragrafët 1 deri në 6 të këtij artikulli duhet të sigurohet.

Neni 11 **Mekanizmi i përshtatjes**

1. Mekanizmi i përshtatjes duhet të marr në konsiderate nën-kompensimin apo mbi-kompensimin e të hyrave të lejuara maksimale bazuar në devijimet ndërmjet të hyrave të parashikuara dhe të hyrave të realizuara, si dhe bazuar në lejimin për borxhet e këqija.
2. Nën-kompensimi apo mbi-kompensimi i të hyrave të lejuara maksimale në një vit, përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të reflektohet në të hyrat e lejuara për periudhën e ardhshme rregullative, si në vijim:
 - a) Ndryshimet ndërmjet konsumit /furnizimit të parashikuar dhe atij aktual duhet të trajtohen në pjesën variable të të hyrave të rishikuara;
 - b) Nëse ndërmarrja e rregulluar dështon në furnizimin e konsumatorëve me ngrohje, pjesa fikse e të hyrave të rishikuara duhet të ulet në përputhje me rrethanat.
3. Të hyrat e parashikuara janë të hyrat e lejuara maksimale që janë aprovuar nga ZRRE në rishikimin vjetor ekzistues për periudhën e ardhshme rregullative.
4. Përshtatja e të hyrave bazohet në komponentë të kostos fikse dhe variable që janë përshtatur për:
 - a) Dallimet ndërmjet kostove aktuale dhe të lejuara fikse dhe variable që nuk janë të kontrollueshme nga ndërmarrja e rregulluar; dhe
 - b) Dallimet ndërmjet sasisë së lejuar dhe aktuale të ngrohjes së gjeneruar apo ngrohjes së konsumuar.
5. Përshtatja e të hyrave do të marrë parasysh edhe borxhin e keq të lejuar, që është zvogëlim në të hyrat e realizuara i shkaktuar nga pamundësia e arkëtimit të pagesave nga konsumatorët dhe llogaritet si një përqindje ndaj të hyrave të lejuara maksimale.

Neni 12 **Kostot e Lejuara Variable të Gjenerimit të Energjisë Termike (ngrohjes)**

1. Kostot e lejuara të gjenerimit të energjisë termike (ngrohjes) llogariten:

- a) Për pikat e përmendura në Nenin 7, paragrafi 6, pika a) kostot llogariten si shumë e kostove të lëndës djegëse dhe shpenzime të tjera duke përfshirë kemikalet dhe ujin, energjinë elektrike dhe kostot direkt të atribueshme të stafit.
 - b) Për pikën e përmendur në Nenin 7, paragrafi 6 pika b) kostot llogariten si komponentë e shumës së kostove të lëndës djegëse dhe shpenzime të tjera duke përfshirë kemikalet dhe ujin dhe kostot direkt të atribueshme të stafit që alokohen për prodhimin e ngrohjes nga njësia e ko-gjenerimit. Parimet e llogaritjes për alokim të kostove variable për ngrohje janë përshkruar në Shtojcën 7.
 - c) Për pikën e përmendur në Nenin 7 paragrafi 6 pika 'c') kostot përbëhen nga komponenti variabil i pagesave për blerjet e jashtme të ngrohjes.
2. Kostot e lëndës djegëse duhet të përcaktohen si sasia e pritshme e konsumit të lëndës djegëse shumëzuar me çmimin e lejuar të lëndës djegëse.
 3. Çmimi i lejuar i lëndës djegëse do të përcaktohet nga ZRRE, duke iu referuar:
 - a) Kostove aktuale të furnizimit të lëndës djegëse; dhe
 - b) Çmimeve aktuale kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare të lëndës djegëse.
 4. Sasia e pritshme e konsumit të lëndës djegëse do të përcaktohet duke iu referuar konsumit specifik të lëndës djegëse, i cili është vlerësuar sipas sasisë së pritshme të energjisë termike (ngrohjes) së gjeneruar nga ajo lëndë djegëse.

Neni 13 Kostot e Bartura

Ndërmarrja e rregulluar e energjisë termike duhet të lejohet që në mënyrë të plotë të bartë taksën vjetore të licencimit apo taksa të tjera administrative (shpenzime) që përshkruhen nga legjislacioni në fuqi, brenda kostove të saj të operimit dhe mirëmbajtjes. Ndërmarrja do të lejohet të bartë edhe çdo kosto tjetër që shkaktohet si rezultat i ndryshimeve në legjislacionin përkatës.

Neni 14 Alokimi i Kostove në Komponentë Fikse dhe Variable

1. Të hyrat e lejuara maksimale do të alokohen në komponentë të kostos fikse dhe variable.
2. Komponenta variable e të hyrave të lejuara maksimale përbëhet nga pjesa variable e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes siç është përcaktuar në Nenin 7 paragrafët 6, 7 dhe 8 si dhe humbjet në rrjet siç janë të përcaktuara në Nenin 10.
3. Komponenta fikse e të hyrave maksimale të lejuara përbëhet nga:
 - a) Pjesa fikse e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes siç është përcaktuar në Nenin 7 paragrafi 4;
 - b) Zhvlerësimi vjetor i lejuar siç është përcaktuar në Nenin 8; dhe
 - c) Kthimi lejuar në asete siç është përcaktuar në Nenin 9.

4. ZRRE mund të rialokoj, një përqindje të caktuar të komponentës fikse të të hyrave të lejuara maksimale në komponentën variabile ose anasjelltas, në mënyrë që të siguroj një raport adekuat të komponentëve fikse dhe variabile të tarifës.

Kapitulli IV Tarifat e Energjisë Termike

Neni 15 Parime të përgjithshme

1. Tarifat duhet të reflektojnë parimin e arsyetimit të kostos dhe grupet e tarifave duhet të ndahen bazuar në kriteret në vijim:
 - a) Sistemi i energjisë termike;
 - b) Pajisjet matëse të instaluar dhe operacionale në nënstationin e kyçjes;
 - c) Struktura e konsumit; dhe
 - d) Karakterin e kostove fikse dhe variabile.
2. Të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifat përkatëse duhet të përcaktohen ndaras për secilin sistem të energjisë termike.
3. Ndërmarrja e energjisë termike duhet të punoj në vazhdimësi për të pajisur të gjithë nënstationet me pajisje matëse dhe të paraqes një plan implementimi (duke përfshirë kostot relevante) tek ZRRE, i cili plan do të merret parasysh në përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave.
4. Struktura tarifore siç përcaktohet në paragrafët 5 deri në 7 të këtij Neni dhe në Nenin 16 duhet të aplikohet pas periudhës së tranzicionit siç është përcaktuar nga ZRRE, para së cilës periudhë struktura e mëparshme tarifore duhet të vazhdohet.
5. Varësisht nga infrastruktura matëse e vendosur, konsumatorët duhet faturohen bazuar në tarifat me matje apo pa matje si në vijim:
 - a) Konsumatorët e kyçur në një nën-stacion i cili është i pajisur me pajisje matëse të instaluar dhe funksionale, pavarësisht nga numri i konsumatorëve të kyçur në këtë nën-stacion, (më tutje “konsumatorët me matje”) do të faturohen bazuar në tarifat me matje – bazuar në konsumin e matur të energjisë termike;
 - b) Konsumatorët në ‘ndërtesat me shumë njësi’ ku ekzistojnë pajisjet matëse të instaluar dhe funksional në nivel njësie, do të faturohen bazuar në tarifat me matje – bazuar në konsumin e matur në nivel nënstationi dhe në nivel njësie – sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën ‘8’ të kësaj Rregulle.
 - c) Konsumatorët në ndërtesat me shume njësi, ku nuk ekzistojnë pajisjet matëse të instaluar dhe funksionale në nivel njësie, do të faturohen sipas tarifave me matje – bazuar në konsumin e matur në nivel nënstationi, i cili do të alokohet tek secili konsumator i kyçur proporcionalisht me sipërfaqen ngrohëse [m²]

- d) Konsumatorët e kyçur në një nën-stacion pa pajisje matëse funksionale (më tutje “konsumatorë pa-matje”) duhet të paguajnë bazuar në tarifa pa matje – bazuar në sipërfaqen e hapësirës së ngrohur.
 - e) Konsumatorët e kyçur në një nën-stacion pa pajisje matëse funksionale, por që posedojnë pajisje matëse në nivel njësie do të faturohen sipas parimeve të përcaktuara në Shtojcën ‘8’ të kësaj Rregulle.
6. Konsumatorët pa-matje duhet më tutje të ndahen në nën-grupe që korrespondon me strukturën e tyre të konsumit, si në vijim:
- a) Konsumatorët rezidencial/shtëpiak; dhe
 - b) Konsumatorët komercial dhe institucional.
7. Tarifat e energjisë termike për të dyja grupet e konsumatorëve me-matje dhe pa-matje duhet të përbëhen nga një komponentë tarifore fikse dhe variabile ashtu që:
- a) Brenda secilës periudhë rregullative të hyrat që ndërmarrja e rregulluar pret të fitoj nga tarifat fikse janë të barabarta me pjesën fikse të të hyrave të lejuara maksimale të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji vetëm nëse ngrohja ka qenë në dispozicion të konsumatorëve.
 - b) Brenda secilës periudhë rregullative të hyrat që ndërmarrja e rregulluar pret të fitoj nga tarifat variabile janë të barabarta me pjesën variabile të të hyrave të lejuara maksimale të aprovuara nga Rregullatori.
8. Parimet e llogaritjes janë përshkruar në Shtojcën 6.

Neni 16

Struktura Tarifore dhe Faturimi

1. Për konsumatorët me matje (siç është përcaktuar në paragrafin 5 të Nenit 15) tarifat duhet të jenë si në vijim:
- a) Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa (pagesa) mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj];
 - b) Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo € cent/kWh];
 - c) Nëse më shumë se një konsumator është i kyçur në një nënstacion (‘ndërtesat me shumë njësi’), atëherë konsumi i matur në këtë nënstacion do të shërbej si matje bazë për faturim, ndërsa alokimi tek konsumatorët bëhet si në vijim:
 - c.1) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën ‘8’; dhe
 - c.2) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ nuk ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi i konsumit të matur në nivel nënstacioni duhet të alokohet tek secili konsumator i kyçur proporcionalisht me sipërfaqen ngrohëse [m²];

2. Për konsumatorët pa-matje (siç është definuar në paragrafin 5 të Nenit 15) tarifat duhet të jenë si në vijim:
 - a) Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në një vlerë të përafërt për kapacitet të ngrohjes për metër katror të hapësirës për ngrohje [€/m² për muaj];
 - b) Komponenti variabil i tarifës: pagesa mujore e energjisë bazuar në një vlerë të përafërt për konsum të ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse [€/m² për muaj];
 - c) Vlerat e parallogaritura për kapacitetin dhe konsumin e ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse duhet të jenë të ndryshme për konsumatorët rezidencial/shtëpiak dhe konsumatorët komercial e institucional dhe të reflektojnë strukturën e tyre specifike të konsumit;
 - d) Vlerat e përafërta për kapacitetin dhe konsumin e ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse duhet të përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji bazuar në analizat e tyre.
3. Ndërmarrja e rregulluar e energjisë termike duhet të lëshoj faturën tek konsumatorët e saj për çdo muaj për secilin nga muajt e sezonit të ngrohjes sipas tarifave siç është specifikuar në paragrafin 1 respektivisht paragrafin 2 të këtij Neni.

Kapitulli V **Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

Neni 17 **Publikimet**

1. Vendimet mbi tarifat e aprovuara duhet të publikohen në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.
2. Dokumentet e parashtruar si dhe dokumentet e tjerë në lidhje me shqyrtimin tarifor, si dhe raportet rregullative si shtojca të vendimeve të nxjerra nga ZRRE do të publikohen në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, përveç materialeve që janë identifikuar si konfidenciale nga aspekti komercial nga entiteti parashtrues, dhe janë pranuar si të tillë nga ZRRE.
3. Ndërmarrjet e energjisë termike do të publikojnë tarifat e rregulluara të aprovuara në të paktën një gazetë ditore që qarkullon brenda Kosovës, brenda 5 ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRRE-së në faqen e saj zyrtare elektronike.

Neni 18 **Gjuha dhe Interpretimi**

1. Rregulla nxjerrët në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.
2. Aplikacioni dhe të gjitha dokumentet që i paraqiten ZRRE-së duhet të jenë në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.
3. Nëse gjatë implementimit të kësaj Rregulle paraqitet ndonjë paqartësi në interpretimin e dispozitave të saj, Bordi i ZRRE-së do të nxjerr sqarime respektivisht do të nxjerr interpretimin valid për dispozitat përkatëse.

Neni 19
Plotësimet dhe Ndryshimet

1. ZRRE ka të drejtën të ndryshoj apo modifikoj ndonjë ose disa dispozita të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshimin apo modifikimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për aprovimin e saj. ZRRE do të ofroj mundësitë e duhura për konsultim me të licencuarit dhe palët e tjera të interesuara.

Neni 20
Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon “Udhëzimin e Përkohshëm I_07_2008 mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë” aprovuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me 14 Qershor 2008.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hynë në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

SHTOJCAT

Shtojca 1

Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

1. Kjo shtojcë përcakton formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të ndërmarrjeve të rregulluara të energjisë termike.
2. Në pajtueshmëri me parimet e përshkruara në nenin 6 të kësaj Rregulle, të hyrat e lejuara maksimale duhet të llogariten për secilën periudhë rregullative duke përdorur formulën në vijim:

$$\text{MAR} = \text{OPM} + \text{DEP} + \text{RTN} + \text{LOS} + \text{ADJ}$$

Ku:

- MAR** Të hyrat e lejuara maksimale;
- OPM** Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 7);
- DEP** zhvlerësimi i lejuar (në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 8);
- RTN** Kthimi i lejuar në asete (në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 9);
- LOS** Kostoja e humbjeve në rrjet për aktivitetin operimit të rrjetit (në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 10);
- ADJ** Faktori i përshtatjes së të hyrave (në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 11).

Llogaritja e Kostos së humbjeve të rrjetit dhe Faktorit të përshtatjes së të hyrave është specifikuar në detaje në paragrafët 3 dhe 4 të kësaj shtojce. Ndërsa llogaritja e Zhvlerësimit të lejuar dhe Kthimit të lejuar në asete është përshkruar në shtojcën 2.

3. Kostoja e lejuar e humbjeve të rrjetit llogaritet si herësi në mes të humbjeve sasiore të rrjetit dhe gjenerimit të energjisë termike (ngrohjes) që hyn në rrjet, kjo e shumëzuar me koston e përgjithshme variable të gjenerimit, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{CLOSS} = (\text{LOSS}_{\text{ALLOW}} / \text{GEN}_{\text{TOTAL}}) * \text{GENCOST}_{\text{VAR}}$$

Ku:

- CLOSS** Kostoja e humbjeve të rrjetit për aktivitetin e operimit të rrjetit [€];
- LOSS_{ALLOW}** Sasia e lejuar e humbjeve në rrjet [MWh];
- GEN_{TOTAL}** Sasia e përgjithshme e gjenerimit të ngrohjes që hyn në rrjet [MWh];
- GENCOST_{VAR}** Kostot variable të gjenerimit të ngrohjes [€].

4. Faktori i përshtatjes së të hyrave llogaritet në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulle, dhe bazohet në ndryshimin në mes të hyrave të lejuara (planifikuara) dhe të hyrave të realizuara, si dhe bazuar në borxhin e keq të lejuar, sipas formulës më poshtë:

$$ADJ_n = (1+R_{adj}) * (AAR_{n-1} - MAR_{n-1} + R_{BD} * MAR_{n-1})$$

Ku:

ADJ	Faktori i përshtatjes së të hyrave në periudhën rregullative aktuale (€);
R_{adj}	Norma e interesit për përshtatje [%];
AAR_{n-1}	Të hyrat të realizuara në periudhën e mëparshme rregullative [€];
MAR_{n-1}	Të hyrat Maksimale të lejuara në periudhën e mëparshme rregullative [€];
R_{BD}	Niveli i lejuar për borxhin e keq gjatë vitit relevant të cilat përcaktohen nga ZRRE, dhe caktohen si vlerë përqindjeje (%).

5. Me qëllim të përcaktimit të tarifave, të hyrat e lejuara maksimale duhet të përbëhen nga pjesa fikse e të hyrave dhe pjesa variabile e të hyrave në pajtueshmëri me Nenin 14 si në vijim:

$$MAR = R_f + R_v$$

Ku:

MAR	Të hyrat maksimale të lejuara;
R_f	Pjesa fikse e të hyrave të lejuara; dhe
R_v	Pjesa variabile e të hyrave të lejuara.

Shtojca 2

Baza e Rregulluar e Aseteve, Zhvlerësimi dhe Kthimi në Asete

1. Kjo shtojcë përshkruan përcaktimin e bazës së rregulluar të asetëve me qëllim të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në asete.
2. Baza e rregulluar e asetëve e tërësishme do të përdoret për përcaktimin e zhvlerësimit të lejuar, dhe do të jetë një vlerë rregullative e asetëve fikse të ndërmarrjes së energjisë termike të konsideruara për t'u përdorur dhe të dobishme për ofrimin e furnizimit me energji termike por duke përjashtuar investimet e pajustificuara:
3. Baza e rregulluar e asetëve me vetë-financim do të përdoret për përcaktimin e kthimit të lejuar në asete dhe do të jetë vlera rregullative e asetëve fikse të ndërmarrjes së energjisë termike të konsideruara për t'u përdorur dhe të jenë të dobishme për ofrimin e furnizimit me energji termike por duke përjashtuar:
 - a) Asetet e siguruara nga kontributet kapitale (grantet, subvencionet etj.); dhe
 - b) Investimet e pajustificuara.
4. Me qëllim të vendosjes së bazës së rregulluar të asetëve dhe përcaktimit të zhvlerësimit, duhet përcaktuar kategoritë dhe jetëgjatësinë respektive të asetëve të rregulluara. Është në kompetencën e ZRRE-së të përcaktojë jetëgjatësinë e asetëve të rregulluara sipas kategorive të asetëve bazuar në praktikën ndërkombëtare rregullative.
5. Për asetet ekzistuese të përdorura, të cilat nuk janë zhvlerësuar në tërësi, jetëgjatësia e mbetur e secilit aset apo grup të asetëve duhet të vlerësohet.
6. Vlera e asetëve të rregulluara para fillimit të periudhës së parë rregullative duhet të jetë shuma totale e vlerave kontabël individuale të asetëve fikse që përdoren dhe janë të dobishme për aktivitetin e rregulluar.
7. Baza e rregulluar e asetëve duhet të azhurnohet para secilës periudhë rregullative si në vijim:

$$\mathbf{RAB}_{\text{nend}} = \mathbf{RAB}_{\text{nstart}} + \mathbf{INV}_n - \mathbf{DIS}_{n-1} - \mathbf{DEP}_{n-1} + \mathbf{WC}_n$$

Ku:

RAB_{nend}	Vlera përfundimtare e lejuar e bazës së rregulluar të asetëve në periudhën rregullative relevante 'n';
RAB_{nstart}	Vlera fillestare e lejuar e bazës së rregulluar të asetëve në periudhën rregullative relevante 'n';
INV_n	Investimet e reja të lejuara/shpenzimet kapitale në periudhën rregullative relevante 'n';
DIS_{n-1}	Tjetërsimet e lejuara në periudhën e mëparshme rregullative 'n-1';
DEP_{n-1}	Zhvlerësimi i lejuar në periudhën e mëparshme rregullative 'n-1'; dhe
WC_n	Kapitali i lejuar punues në periudhën rregullative relevante 'n'.

8. Kapitali punues zakonisht përfshinë vlerën e rezervave të nevojshme të lëndës djegëse dhe pjesëve rezervë, si dhe ndryshimit në mes të vlerës së faturimit të konsumatorëve (llogaritë e arkëtueshme) dhe pagesës së mbledhur nga konsumatorët. Kapitali punues nuk mund të kalojë vlerën e të hyrave të lejuara mesatare për një muaj, d.m.th. 1/12 e të hyrave vjetore të lejuara.
9. Baza e rregulluar e asetëve të vetë-financuara ($RAB_{t,sf\ end}$) do të jetë Baza e rregulluar e asetëve totale pa përfshirë asetet e financuara nga kontributet kapitale (donacionet, subvencionet etj.).
10. Kthimi i lejuar llogaritet bazuar në Bazën e rregulluar të asetëve të vetë-financuara dhe Mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit, sipas formulës:

$$RTN = RAB_{n,sf\ end} * WACC$$

Ku:

RTN	Kthimi i lejuar në asete [€];
$RAB_{n,sf\ end}$	Baza e rregulluar të asetëve të vetë-financuara; dhe
WACC	Mesatarja e Ponderuar e kostos së kapitalit [%] – e përshkruar detajisht në Shtojcën 3.

11. Trajtimi i investimeve të reja dhe përfshirja në bazën e rregulluar të asetëve duhet të jetë në përputhje me këto parime:
 - a) Shpenzimet e lejuara kapitale do të shtohen në Bazën e rregulluar të asetëve nga data kur asetë është vënë në shërbim dhe në koston e lejuar nga ZRRE në planin investiv.
 - b) ZRRE duhet të përfshijë koston aktuale në vend të kostos së lejuar të një investimi të ri në bazën e rregulluar të asetëve me kërkesën e ndërmarrjes së rregulluar dhe vetëm nëse ndërmarrja mund të demonstrojë qartazi se dallimi ndërmjet kostove të lejuara dhe aktuale është në sajë të faktorëve jashtë kontrollit të ndërmarrjes së rregulluar dhe se përpjekjet më të mira janë bërë për të minimizuar rritjet e kostos.
 - c) Nëse një investim i ri në planin e aprovuar investiv nuk është vënë në shërbim në periudhën aktuale rregullative, kostoja e tij e lejuar nuk duhet të shtohet tek baza e rregulluar e asetëve dhe çdo e hyrë e fituar nga ky investim në periudhën aktuale rregullative duhet të zbritet nga të hyrat në periudhën e ardhshme rregullative.

Shtojca 3

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

1. Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) do të llogaritet para aplikimit të tatimit në fitim sipas formulës në vijim:

$$WACC = (1 - g) * R_E / (1 - t) + g * R_D$$

Ku:

WACC Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (%);

g "Gearing" apo niveli i borxhit i përcaktuar si përqindje e kapitalit të përgjithshëm: borxhi/(ekuiteti + borxhi) (%);

R_E Kthimi në ekuitet (%);

R_D Kthimi në borxh (%); dhe

t Tatimi në fitim i korporatave në Kosovë.

2. Vlerat për komponentët e WACC do të përcaktohen nga ZRRE në konsultim me ndërmarrjet e rregulluara.
3. Vlera e "gearing" (g) do të jetë në mes të vlerave '0' dhe '1', dhe paraqet pjesëmarrjen e borxhit në financimin total. Kjo vlerë do të përcaktohet duke u bazuar në një qasje balancuese të miksit të financimit të ndërmarrjes së rregulluar dhe miksit të financimit që pritet të jetë i arritshëm në të ardhmen duke marrë parasysh edhe miks optimal të financimit për ndërmarrjet e ngjashme.
4. Kthimi në ekuitet do të llogaritet bazuar në Modelin për vënien e çmimeve të aseteve kapitale (Capital Asset Pricing Rule CAPM), sipas formulës në vijim:

$$R_e = r_f + \beta * ERP$$

Ku :

r_f Norma pa risk;

β Beta ekuiteti; dhe

ERP Premium i riskut të ekuitetit.

5. Norma pa risk (rrezik) parqet koston e borxhit jo-koncesionar shtetëror në Kosovë (në terma realë) apo në shtetet me një klasifikim të ngjashëm të kreditit si Kosova.
6. Ekuiteti beta shpreh rrezikun sistematik dhe është një korrelacion ndërmjet kthimit në asete kapitale individuale dhe kthimit në treg.
7. Premium i riskut të ekuitetit (ERP) përkufizohet si ndryshim ndërmjet të ardhura mesatare të investimeve me rrezik dhe normës pa rrezik.

8. Kthimi në borxh do të jetë mesatarja e normës së interesit e kredive ekzistuese afatgjata (që tejkalojnë një vit) tek ndërmarrja e rregulluar, shprehur në terma realë dhe e matur sipas vlerës në Euro të secilës kredi.
9. ZRRE mund të vendos WACC tërë për sektorin e energjisë termike nëse konsiderohet e arsyeshme.

Shtojca 4

Aplikimi për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat

1. Aplikacioni për aprovimin e të hyrave dhe tarifave të ngrohjes duhet të specifikoj:
 - a) Emrin e aplikantit, adresën e ndërmarrjes, emrin e personin kontaktues, certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe numrin e regjistrimit të tatimit të aplikantit;
 - b) Propozimin dhe arsyetimin e plotë për të hyrat dhe tarifave të kërkuara; dhe
 - c) Aplikacioni duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar që përfaqëson aplikantin.

2. Së bashku me aplikacionin, aplikanti duhet të paraqes në ZRRE dokumentet vijuese:
 - a) Pasqyrat vjetore financiare statutore (pasqyrën e të ardhurave, balancin e gjendjes dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë) për vitin e fundit kalendarik duke bashkëngjitur raportin e auditorit nëse pasqyrat financiare të aplikantit kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur financiar.
 - b) Përshkrim i detajuar i fondeve në dispozicion dhe/ose burimet e financimit për kryerjen e aktivitetit dhe dëshminë e vlefshmërisë së këtyre fondeve/burimeve të financimit.
 - c) Llogaritje të detajuara, evidencë dhe justifikime për llogaritjet e çdo elementi të tarifave në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj Rregulle.
 - d) Të dhëna lidhur me të hyrat e para-vlerësuara nga shitjet e ngrohjes tek konsumatorët fundor, kostot e përgjithshme të parashikuara të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të ngrohjes, planin investiv (nëse është ndonjë) dhe pasqyrat financiare të parashikuara (Pasqyra e të ardhurave, Bilanci i gjendjes dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë të parashikuara), kapaciteti i përgjithshëm i kontraktuar i ngrohjes dhe prodhimi vjetor i përgjithshëm i parashikuar i ngrohjes në MWh – ky informacion duhet të mbuloj periudhën njëvjeçare nga 15 Tetori i vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit vijues.
 - e) Zbërthim i detajuar i elementeve të kostos dhe shpjegimet dhe dokumentacion shoqërues për të justifikuar dhe sqaruar të dhënat dhe informacionin e parashikuar që është deklaruar.
 - f) Një deklaratë teknike që sqaron statusin e çështjeve të caktuara. Kjo përfshin statusin dhe planin për instalimin e matësve në nënstacionet pa-matje. Një llogaritje dhe vlerësim të humbjeve të energjisë në rrjetin e distribucionit dhe një plan me masa të synuara që kanë për qëllim të reduktojnë humbjet e energjisë në rrjet.
 - g) Një listë të të gjithë dokumenteve të paraqitur.

3. Nëse aplikanti synon të zbatoj një projekt afatgjatë investiv, përveç dokumenteve të specifikuar në paragrafin 2 të kësaj shtojce, duhet të paraqes:
 - a) Modelin financiar për periudhën e projektit;
 - b) Përshkrimin e parametrave të rëndësishme të modelit financiar;
 - c) Marrëveshjet e nënshkruara të cilat drejtojnë zbatimin e projektit dhe parimet e vënies së çmimeve (nëse ka); dhe
 - d) Justifikim të plotë për arsyet e një investimi të tillë.

Shtojca 5

Procedura për Verifikim dhe Ekzaminim Formal

1. Kur një aplikacion vlerësohet i kompletuar dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle, ZRRE duhet të ekzaminoj të gjitha të dhënat që përmban aplikacioni dhe po ashtu dokumentet e bashkëngjitur.
2. ZRRE mund të verifikoj me nismën e vet të dhënat pasqyruara dhe rrethanat, mund të kontaktoj ndërmarrjet e ngrohjes dhe të kërkoj informata dhe dokumente shtesë.
3. Ndërmarrjet e energjisë termike duhet t'i ofrojnë ZRRE-së dokumente dhe informata në përputhje me Nenin 4 të kësaj Rregulle.
4. Brenda një kornize kohore të specifikuar në Planin Zbatues dhe Orarin, pas pranimit të aplikacionit, ZRRE duhet të ekzaminoj dokumentin e parashtruar, pjesët e bashkëngjitura dhe dokumentet e kërkuara.
5. Në rast të mospërputhjes apo nëse dokumentet e kërkuara nuk janë bashkëngjitur, ZRRE duhet ta njoftoj me shkrim aplikantin. Njoftimi me shkrim duhet t'i bëj thirrje aplikantit të korrigjoj aplikacionin e tij brenda një kornize kohore të specifikuar në Planin Zbatues dhe Orari nga data e njoftimit.
6. Në rast se aplikanti dështon të korrigjoj mospërputhshmërinë e aplikacionit të tij, të ofroj të dhënat dhe dokumentet shtesë të kërkuar në brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 5 të kësaj Shtojce, ZRRE do të refuzoj aplikimin dhe do të njoftoj aplikantin me shkrim brenda një kornize kohore të specifikuar në Planin Zbatues dhe Orari nga data e përcaktuar në paragrafin 5.
7. Në rast të dështimit të aplikantit që të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 6, ZRRE do të vendos gjoba në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë deri në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 5, dhe do të vendos tarifën e ngrohjes bazuar në informacionet ekzistuese dhe sipas vlerësimit të vet më të mirë.

Shtojca 6 Detaje për Llogaritjen e Tarifave

1. Kërkesat e të hyrave duhet të alokohen në tarifatat për grupe të ndryshme të konsumatorëve në përputhje me parimet e përcaktuara në kapitullin IV të kësaj Rregulle.
2. Konsumatorët duhet të ndahen në grupe të konsumatorëve, për qëllime tarifore, bazuar në Nenin 16 paragrafi 4 dhe 5 të kësaj Rregulle.
3. Alokimi duhet të përcaktohet nga raporti i kapacitetit të ngrohjes së angazhuar për pjesën fikse të të hyrave dhe nga raporti i kërkesës për ngrohje (konsumit të ngrohjes) për pjesën variabile të të hyrave si në vijim:

$$R_{fi} = R_f * HP_i / \Sigma HP, \text{ dhe}$$
$$R_{vi} = R_v * HD_i / \Sigma HD$$

Ku:

- R_{fi}** Komponenta e pjesës fikse të të hyrave për grupin e konsumatorëve 'i' (€);
R_f Pjesa fikse e të hyrave të lejuara maksimale (€);
HP_i Kapaciteti i angazhuar për grupin të konsumatorëve 'i' (kW);
ΣHP Totali i kapacitetit të angazhuar për të dy grupet e konsumatorëve (kW);
R_{vi} Komponenta e pjesës variabile të grupit të konsumatorëve 'i' (€);
R_v Pjesa variabile e të hyrave të lejuara maksimale (€);
HD_i Kërkesa e sezonit të ngrohjes e grupit të konsumatorëve 'i' (MWh); dhe
ΣHD Kërkesa totale e sezonit të ngrohjes (MWh).

4. Kapaciteti i angazhuar i ngrohjes së një grupi të konsumatorëve duhet të jetë i barabartë me kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes të këtij grupi apo e llogaritur si në vijim:

$$HP_i = CD_i * HS_i / 1000$$

Ku:

- HP_i** Kapaciteti i angazhuar për grupin e konsumatorëve 'i' (kW);
CD_i Kërkesa specifike për ngrohje e grupit të konsumatorëve 'i' (W/m²)
HS_i Sipërfaqja për ngrohje e grupit të konsumatorëve 'i' (m²)

5. Kërkesa specifike e kapacitetit për ngrohje paraqet kërkesën e vlerësuar të kapacitetit për ngrohje për metër katror (përcaktuar si kërkesa për ngarkesë maksimale për metër katror për temperaturën e përcaktuar të jashtme) për secilin grup të konsumatorëve.
6. Kërkesa e sezonit të ngrohjes duhet të jetë e barabartë me konsumin e matur apo e llogaritur duke përdorur formulën në vijim:

$$HD_i = CD_i * LH_i * HS_i * 10^6$$

Ku:

- HD_i** Kërkesa e sezonit të ngrohjes të grupit të konsumatorëve 'i' (MWh);
CD_i Kërkesa specifike për ngrohje e grupit të konsumatorëve 'i' (W/m²);
LH_i Orët nominale të ngarkesës së plotë të grupit të konsumatorëve 'i' (h); dhe
HS_i Sipërfaqja e ngrohur e grupit të konsumatorëve 'i' (m²).

7. Orët nominale të ngarkesës së plotë për ngrohje bazohen në kërkesat specifike lidhur me vazhdimësinë e furnizimit dhe janë llogaritur si përpjesëtim ndërmjet sasisë vjetore të ngrohjes së furnizuar tek konsumatorët dhe kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes për secilin grup të konsumatorëve.

8. Tarifat e konsumatorëve fundor duhet të llogariten si në vijim:

a) Për konsumatorët pa-matje siç është përcaktuar në Nenin 15:

$$t_{fni} = R_{fi} / HP_i * CD_i / 6 ; \text{ dhe}$$
$$t_{vni} = R_{vi} / HD_i * CD_i * LH_i / 1000 / 6$$

Ku:

- t_{fni}** Tarifa fikse/tarifa e kapacitetit për grupin e konsumatorëve pa-matje 'i' (€/m² për muaj);
R_{fi} Komponenta e pjesës fikse të të hyrave për grupin e konsumatorëve 'i' (€);
HP_i Kapaciteti i angazhuar i grupit të konsumatorëve 'i' (kW);
CD_i Kërkesa specifike për ngrohje (kapaciteti) i grupit të konsumatorëve 'i' (kW/m²);
t_{vni} Tarifa variabile/ tarifa e energjisë për grupin e konsumatorëve pa-matje 'i' (€/m² për muaj);
R_{vi} Komponenta e pjesës variabile të të hyrave për grupin e konsumatorëve 'i' (€);
HD_i Kërkesa e sezonit të ngrohjes e grupit të konsumatorëve 'i' (MWh); dhe
LH_i Orët nominale të ngarkesës së plotë të grupit të konsumatorëve 'i' (h).

b) Për konsumatorët me-matje siç është përcaktuar në Nenin 15:

$$t_{fi} = R_{fi} / HP_i / 6 ; \text{ dhe}$$
$$t_{vi} = R_{vi} / HD_i$$

Ku:

- t_{fi}** Tarifa fikse/ tarifa e kapacitetit për grupin e konsumatorëve me-matje 'i' (€/kW për muaj);
R_{fi} Komponenta e pjesës fikse të të hyrave për grupin e konsumatorëve 'i' (€);
HP_i Kapaciteti i angazhuar për grupin e konsumatorëve 'i' (kW);
t_{vi} Tarifa variabile/tarifa e energjisë për grupin e konsumatorëve me-matje 'i' (€/MWh për muaj);
R_{vi} Komponenta e pjesës variabile të të hyrave për grupin e konsumatorëve 'i' (€); dhe
HD_i Kërkesa e sezonit të ngrohjes e grupit të konsumatorëve 'i' (MWh).

9. Kur të arrihet matja e plotë dhe e besueshme, vlerat e matura duhet gjithmonë të preferohen dhe mbizotërojnë mbi vlerat e llogaritura apo të vlerësuara për qëllime të përcaktimit të tarifave.

Shtojca 7

Metodologjia e Alokimit të Kostove për Kogjenerimin e Energjisë Elektrike dhe Termike

Metoda e shpërndarjes së përfitimit (benefiteve) është aplikuar për alokimin e kostove në energji dhe ngrohje për ko-gjenerimin vetanak. Sipas kësaj metode, lëndët djegëse të përdorura në procesin teknologjik të ko-gjenerimit janë alokuar për energji elektrike dhe ngrohje në proporcion me konsumin e lëndës djegëse për format alternative të furnizimit me energji. Alternativat e përdorura janë kaldajat e prodhimit të energjisë elektrike me kondensim dhe kaldajat vetëm për energji termike për prodhimin e energjisë termike me të njëjtën lëndë djegëse dhe me të njërin kapacitet në dalje sikurse impianti i kogjenerimit. Konsumi i lëndëve djegëse në mënyrat alternative të prodhimit të energjisë, F'_e për energjinë elektrike dhe F'_h për energjinë termike, mund të llogaritet bazuar në ekuacionin në vijim:

$$F'_e = E/\eta_e$$

$$F'_h = H/\eta_h$$

Ku:

E Prodhimi i energjisë elektrike në impiantin e ko-gjenerimit;

η_e Eficienca e formës alternative të prodhimit të energjisë elektrike (energji elektrike nga kaldajat kondensuese);

H Prodhimi i energjisë termike në impiantin e kogjenerimit; dhe

η_h Eficienca e formës alternative të prodhimit të energjisë termike (kaldajat për prodhimin e energjisë termike).

Vlerat standarde të përdorura për eficiencën e prodhimit alternativ janë:

$$\eta_e = 0,4$$

$$\eta_h = 0,9$$

Konsumi i lëndës djegëse në impiantin e kogjenerimit, F , është ndarë ndërmjet energjisë elektrike dhe energjisë termike në përputhje me përpjesëtimin me konsumin e lëndës djegëse të formave alternative të furnizimit me energji elektrike dhe energji termike F'_e and F'_h si në vijim:

$$F_e = F'_e / (F'_e + F'_h) * F$$

$$F_h = F'_h / (F'_e + F'_h) * F$$

Kostot variable janë alokuar në energji elektrike dhe energji termike duke përdorur të njëjtin përpjesëtim i cili është përdorur më lartë për alokimin e konsumit të lëndës djegëse për energji termike dhe energji elektrike.

Shtojca 8

Metodologjia e alokimit të kostos së ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi (kolektive)

1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1 Qëllimi kryesor i metodologjisë së alokimit të kostos së ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi (në tekstin e mëtejshëm 'Metodologjia') është të zbatohet faturimin e bazuar në konsum, duke udhëzuar kompanitë e furnizimit të NQ-së se si të llogarisin faturën e ngrohjes për klientët që banojnë në ndërtesat me shumë e njësi.
- 1.2 Metodologjia zbatohet nga kompanitë e NQ-së që kanë licencë për furnizim me energji termike (ngrohje) të lëshuar nga ZRRE; do të zbatohet për llogaritjen e faturës së ngrohjes për klientët që banojnë në ndërtesat shumë njësi të lidhura me sistemin e ngrohjes qendrore.
- 1.3 Metodologjia do të zbatohet për të gjitha ndërtesat me shumë njësi (kolektive), ku ka matje funksionale të ngrohjes në nivel të nënstacionit të ndërtesës dhe në nivel të njësisë.
- 1.4 Pavarësisht nga lloji i instalimeve të ngrohjes qendrore të ndërtesave (instalimi i ngrohjes qendrore 'vertikale' ose 'horizontale') dhe rregullimet përkatëse të matjes së nxehtësisë në nivelin e njësisë (HCA ose matësi individuale i ngrohjes i njësisë), metodologjia do të zbatohet për të dyja rastet.

2 Parimet kryesore dhe qasja për hartimin e Metodologjisë

- 2.1 Parimet kryesore të mëposhtme do të rregullojnë këtë Metodologji:
 - a) Fatura e ngrohjes e konsumatorit duhet të jetë e drejtë dhe transparente duke reflektuar konsumin aktual të matur dhe të vlerësuar të ngrohjes të njësisë në pronësi të atij konsumatori;
 - b) Faturimi bazohet në konsumin e matur në nivelin e nënstacionit termik dhe duke marrë parasysh matjet në nivel të njësisë dhe rregullimet tjera specifike që pasqyrojnë nxehtësinë e pa matur në nivelin e njësisë, siç është transmetimi i nxehtësisë nga rrjeti i përbashkët i tubacioneve të ndërtesave dhe nga transmetimi i nxehtësisë nga muret/tavanet ndërmjet njësisë të ndërtesës. Për këtë qëllim, bilanci i furnizimit/konsumit të ngrohjes së ndërtesës do të jetë baza për alokimin e kostove të ngrohjes dhe llogaritjen e mëtejshme të faturave të ngrohjes së konsumatorëve.
 - c) Matja kryesore e ngrohjes bëhet në nënstacionin termik të ndërtesës, i cili është pika ndarëse (kufizuese) ndërmjet furnizuesit të ngrohjes dhe konsumatorit; matja e ngrohjes në nivelin e nënstacionit është matja e referente për kompaninë e furnizimit me ngrohje që duhet të kompensohet për ngrohjen e furnizuar në një ndërtesë.
 - d) Për faturimin e bazuar në konsum do të zbatohet e ashtuquajtura 'tarifa për konsumatorët me matje' e lëshuar nga ZRRE; kjo tarifë përbëhet nga komponenti i tarifës së kapacitetit dhe komponenti i energjisë.

- e) Fatura e ngrohjes e konsumatorëve që banojnë në ndërtesat kolektive do të përbëhet nga: i) komponentët fiks: që merr parasysh kapacitetin termik të konsumatorit dhe konsumin e përbashkët të energjisë termike (ngrohjes) të ndërtesës, dhe do t'u tarifohen konsumatorëve pavarësisht nga sasia e ngrohjes së konsumuar; dhe ii) komponenti variabël që do të llogaritet në bazë të sasisë së matur të ngrohjes së konsumuar.

2.2 Metodologjia shfrytëzon qasjen që bazohet në bilancin e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) për ndërtesën si tërësi, e cila merr parasysh si në vijim:

- Ndrohja e matur në nivelin e nënstacionit termik është matja kryesore referente e ngrohjes së furnizuar në ndërtesë për të cilën kompania e furnizimit me ngrohje duhet të kompensohet;
- Diferenca ndërmjet sasisë së ngrohjes të matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës dhe konsumit të përbashkët të të gjitha njësive të ndërtesës (matur në nivel njësie) do të shpërndahet proporcionalisht me sipërfaqen e ngrohjes të secilës njësi;
- Sipas kësaj, fatura individuale e ngrohjes e çdo konsumatori- pronari të njësisë - duhet të marrë parasysh konsumin e ngrohjes të matur në nivel të njësisë dhe pjesën përkatëse të konsumit të përbashkët të ndërtesës, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet konsumit të nxehtësisë të matur në nivel të nënstacionit dhe konsumit të përbashkët të ngrohjes së të gjitha njësive të matura në nivelin e njësisë;
- Pjesa e konsumit të përbashkët të ndërtesës ndahet për njësitë e ndërtesës në proporcion me sipërfaqen e ngrohur të secilës njësi.

3 Bilanci i konsumit të energjisë termike (ngrohjes) së një ndërtesë me shumë njësi (kolektive)

3.1 Në bazë të fushëveprimit të Metodologjisë (1.2 – 1.4), parimeve kryesore (2.1) dhe qasjes për hartimin e Metodologjisë (2.2), bilanci i konsumit të nxehtësisë së një ndërtesë kolektive përgatitet në çdo muaj të sezonit të ngrohjes para përgatitjes së faturave.

3.2 Bilanci i konsumit të ngrohjes së ndërtesës me shumë njësi duhet të kryhet për shkak të specifikave të dizajnit teknik dhe konfigurimit të instalimeve të ngrohjes qendrore dhe aranzhimeve përkatëse të matjes së ngrohjes, të përmbledhura si më poshtë:

- a) Konsumi i energjisë termike (ngrohjes) i të gjithë ndërtesës me shumë njësi (kolektive) matet në nivelin e nënstacionit nga matësi i ngrohjes;
- b) Në ndërtesat me shumë njësi me instalime të ngrohjes qendrore 'vertikale', konsumi i nxehtësisë së njësisë vlerësohet (llogaritet) duke përdorur alokatorët e kostos së ngrohjes të montuar në çdo radiator që llogarisin nxehtësinë e transmetuar nga radiatorët;
- c) Në ndërtesat me shumë njësi me instalime të ngrohjes qendrore 'horizontale', konsumi i ngrohjes së njësisë matet duke përdorur matësin e ngrohjes të instaluar në pikën e lidhjes që hyn në njësi, i cili mat konsumin e ngrohjes në njësi;
- d) Në ndërtesën me shumë njësi, krahas konsumit të ngrohjes së njësive, është prezent edhe 'konsumimi i përbashkët', në formën e: i) transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë

nëpër hapësirat e përbashkëta të ndërtesave (korridoret, shkallët etj.); ii) transmetimi i nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër njësi (në rastin e përdorimit të HCA-ve të montuar në radiatorë); dhe iii) transmetimin e nxehtësisë ndërmjet mureve dhe tavaneve të njëjësive ngjitur.

- 3.3 Bilanci i konsumit të nxehtësisë do të marrë parasysh konsumin e ngrohjes së matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës, konsumin e ngrohjes të matur në nivelin e njësisë dhe 'konsumin e përbashkët' që nuk matet; për një ndërtesë me shumë njësi formula bazë e bilancit të konsumit të ngrohjes është:

$$(1) \quad \mathbf{BHC}_{MS-L} = \sum_{i=1}^n \mathbf{U}_i \mathbf{HC}_{MU-L} + \mathbf{CHC}_{NM}$$

Ku:

BHC_{MS-L} - është konsumi i ngrohjes i të gjithë ndërtesës i matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës;

$\sum_{i=1}^n \mathbf{U}_i \mathbf{HC}_{MU-L}$ - shuma e konsumit të ngrohjes së njëjësive të matur në nivelin e njësisë;

n - numri i njëjësive në ndërtesë; dhe

CHC_{NM} - 'Konsumi i përbashkët i ngrohjes' që përfshin nxehtësinë e transmetuar nga tubat dhe transmetimin e nxehtësisë brenda ndërtesës, të cilat nuk maten në mënyrë të veçantë.

- 3.4 Konsumi i përgjithshëm i njëjësive ($\sum \mathbf{U}_i \mathbf{HC}_{MU-L}$) llogaritet ndryshe në rastin kur HCA përdoren për të matur konsumin e ngrohjes së njësisë dhe në rastin kur matësit individualë të ngrohjes përdoren për të matur konsumin e ngrohjes së njësisë; detaje për secilin rast janë dhënë në paragrafët e mëposhtëm (3.5 dhe 3.6).

- 3.5 Llogaritja e konsumit të përgjithshëm të njëjësive të ndërtesës ($\sum \mathbf{U}_i \mathbf{HC}_{MU-L}$) kur konsumi i ngrohjes së njësisë matet me Alokatorët e Kostos së Ngrohjes (HCA) përfshin llogaritjen me dy hapa:

- a) Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjithë radiatorët e çdo njësie, që paraqet shumën e nxehtësisë së transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësisë:

$$(2) \quad \mathbf{UHC}_{MU-L(HCA)} = \sum_{i=1}^r \mathbf{HTR}_i$$

Ku:

UHC_{MU-L(HCA)} - Konsumi i ngrohjes së njësisë që matet duke përdorur HCA;

$\sum HTR_i$ – Nxehtësia e transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësisë të matur nga HCA; dhe

'r' – Numri i radiatorëve në njësi.

b) Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjitha njësitë e ndërtesës, sipas formulës:

$$(3) \quad \sum_{i=1}^n U_i H C_{MU-L(HCA)} = U_1 H C_{MU-L(HCA)} + U_2 H C_{MU-L(HCA)} + \dots + U_n H C_{MU-L(HCA)}$$

Ku:

'n' është numri i njësive në ndërtesën kolektive.

3.6 Llogaritja e konsumit të përgjithshëm të njësive të ndërtesës ($\sum UHC_{MU-L}$), kur konsumi i ngrohjes së njësive matet me matës individual të ngrohjes të njësive (UHM) përfaqëson shumën e konsumit të ngrohjes së çdo njësie të ndërtesës, sipas formulës:

$$(4) \quad \sum_{i=1}^n U_i H C_{MU-L(UHM)} = U_1 H C_{MU-L(UHM)} + U_2 H C_{MU-L(UHM)} + \dots + U_n H C_{MU-L(UHM)}$$

Ku:

$UHC_{MU-L(UHM)}$ – Konsumi i ngrohjes së njësive të matur me matësit individual të ngrohjes (UHM);

'n' është numri i njësive në ndërtesën kolektive.

3.7 'Konsumimi i përbashkët i nxehtësisë' (CHC), siç përshkruhet në detaje në paragrafin 3.2. 'd', i referohet nxehtësisë së transmetuar nga tubat e instalimit dhe transmetimit të nxehtësisë ndërmjet ndarjeve të ndërtesës (njësi/hapësira të përbashkëta); CHC është i vetmi element i formulës bazë të bilancit të konsumit të nxehtësisë (1) që nuk matet dhe rrjedh nga formula (1):

$$(5) \quad CHC_{NM} = BHC_{MS-L} - \sum_{i=1}^n U_i H C_{MU-L}$$

3.8 'Konsumi i përbashkët i ngrohjes' i llogaritur me formulën (5) do t'u ndahet (alokohet) konsumatorëve individualë – pronarëve të njësive të ndërtesës – proporcionalisht me sipërfaqen e ngrohjes të secilës njësi; detajet e alokimit janë paraqitur në seksionin vijues '4'.

4 Shpërndarja e konsumit të përbashkët të nxehtësisë së ndërtesës

- 4.1 'Konsumimi i përbashkët i ngrohjes' i një ndërtese me shumë njësi (kolektive) ju alokohet njësie të ndërtesës në përpjesëtim me sipërfaqen e ngrohjes të secilës njësi, duke përdorur koeficientin e shpërndarjes së sipërfaqes të llogaritur për çdo njësi sipas formulës:

$$(6) \quad k_{UAA} = \frac{UA}{\sum_{i=1}^n U_i A}$$

Ku:

k_{UAA} - Koeficienti i shpërndarjes së sipërfaqes së njësisë;

UA - Sipërfaqja e njësisë të ndërtesës kolektive (në m²);

$\sum_{i=1}^n U_i A$ – Sipërfaqja totale e të gjitha njësive të ndërtesës, si shuma e sipërfaqeve të të gjitha njësive të një ndërtese (m²);

'n' - numri i njësive në ndërtesat kolektive.

- 4.2 Pjesa e konsumit të përbashkët të ndërtesës që i alokohet në njësie të ndërtesës përfaqëson alokimin e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të ndërtesës në një njësi të caktuar dhe llogaritet duke përdorur koeficientin e shpërndarjes së sipërfaqes së njësisë, sipas formulës më poshtë:

$$(7) \quad US_{CHC} = k_{UAA} * CHC_{NM}$$

Ku:

US_{CHC} – Pjesa e konsumit të përbashkët të ngrohjes për një njësi (në kWh) - pjesa e 'konsumit të përbashkët të nxehtësisë' të ndërtesës me shumë njësi që i ndahet një njësie të caktuar të ndërtesës;

k_{UAA} - Koeficienti i alokimit të sipërfaqes së njësisë;

CHC_{NM} – 'Konsum i përbashkët i ngrohjes' i ndërtesës me shumë njësi (në kWh) - që llogaritet sipas formulës (5)

5 Llogaritja e faturës së ngrohjes së konsumatorit individual

- 5.1 Në bazë të tarifës për 'konsumatorët me matje' të lëshuar nga ZRRE dhe parimeve kryesore të kësaj Metodologjie (2.1 'd' dhe 'e'), fatura e ngrohjes së konsumatorit individual – pronarit të njësisë – në ndërtesën me shumë njësi do të përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:
- a) Komponenti i kapacitetit termik – që është tarifa për kapacitetin termik të një njësie në pronësi të konsumatorit individual të ngrohjes; komponenti i kapacitetit termik do të konsiderohet si ngarkesë fikse e pavarur nga konsumi i ngrohjes së një njësie të tillë.

- b) Komponenti i alokimit të ngrohjes – që është ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'Konsumit të përbashkët të nxehtësisë' të ndërtesës që i ndahet një njësie; komponenti i alokimit të ngrohjes do të konsiderohet si tarifë fikse e pavarur nga konsumi i nxehtësisë së një njësie të tillë.
- c) Komponenti i konsumit të ngrohjes - kjo është ngarkesa (pagesa) për sasinë e konsumuar të ngrohjes matur në nivelin e njësisë (me anë të HCA ose matësit individual të ngrohjes së njësisë).

5.2 Ngarkesa për komponentin e kapacitetit termik përfaqëson ngarkesën (pagesën) fikse për konsumator individual, pavarësisht nga konsumi i matur i ngrohjes i njësisë së konsumatorit; llogaritet duke shumëzuar kapacitetin termik të njësisë dhe tarifën e kapacitetit termik, sipas formulës:

$$(8) \quad TCC = HCU * HCT$$

Ku:

TCC – Tarifa e kapacitetit termik (në €);

HCU – Kapaciteti termik i njësisë (në kW) – HCU përcaktohet nga furnizuesi i ngrohjes bazuar në metodologjinë e propozuar nga furnizuesi i ngrohjes në marrëveshje me ZRRE-në;

HCT – Tarifa e kapacitetit termike (në €/kW në muaj) – komponenti fiks i tarifës për konsumatorët 'me matje' e lëshuar nga ZRRE.

5.3 Ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të njësisë, që përfaqëson pjesën e konsumit të përbashkët të ndërtesës kolektive të alokuar për një njësi të caktuar, konsiderohet si ngarkesë (pagesë) fikse për konsumatorin individual, pavarësisht nga konsumi i matur i ngrohjes së njësisë së konsumatorit; llogaritet duke shumëzuar pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të njësisë me tarifën e konsumit të energjisë termike (ngrohjes), sipas formulës:

$$(9) \quad CUS_{CHC} = US_{CHC} * TET$$

Ku:

CUS_{CHC} – Ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të njësisë në (në€);

US_{CHC} - Pjesa e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' së njësisë (në kWh), e llogaritur sipas formulës (7);

TET – Tarifa e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) (në €/kWh) – komponenti variabël i tarifës për konsumatorët 'në matje' e lëshuar nga ZRRE.

5.4 Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (HCC) e matur në nivel të njësisë, përfaqëson ngarkesën variabël për konsumatorin individual për konsumin e ngrohjes së matur në nivelin e njësisë; llogaritet me formulën:

$$(10) \quad HCC = UHC_{MU-L} * TET$$

Ku:

HCC – Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (në €);

UHC_{MU-L} - është konsumi i ngrohjes i njësisë (në kWh) që matet në nivelin e njësisë;

TET – Tarifa e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) (në €/kWh) – komponenti variabël i tarifës për konsumatorët 'me matje' e lëshuar nga ZRRE

- 5.5 Shuma totale e faturës së ngrohjes së klientit individual është shuma e tre komponentëve të faturës siç llogaritet sipas paragrafëve 5.2 – 5.4

Aneks: Shembull i llogaritjes së faturës së ngrohjes për njësi në një ndërtesë me shumë njësi

Për të lehtësuar zbatimin e Metodologjisë është dhënë shembulli i llogaritjes së faturës së ngrohjes për konsumator individual – pronar të njësisë. Para kryerjes së llogaritjes, vizualizohet një mostër e ndërtesës tipike me shumë njësi (kolektive) dhe njësia mostër, e pasuar nga parashikimi i inputeve përkatëse që përfshijnë: numrin dhe llojet e njësive me hapësirat përkatëse të ngrohjes, konsumin e ngrohjes së të gjithë ndërtesës (e matur në nivel të nënstacionit) dhe konsumin e njësive (e matur në nivel të njësisë). Më tej, shembulli detajon llogaritjen e secilit komponent të faturës sipas formulave të Metodologjisë.

1. Shembull i ndërtesës kolektive dhe njësive të mostrës

1.1 Struktura e strukturës së ndërtesës mostër

- Një ndërtesë 6 katëshe e përbërë nga 24 njësi;
- 4 lokale afariste ndodhen në katin përdhësë;
- 5 katet e tjera kanë 20 apartamente, çdo kat nga 4 apartamente.

1.2 Inputet – Sipërfaqet e njësive

- <u>Sipërfaqet e lokale afariste (CP):</u>	- <u>Sipërfaqet e apartamenteve (AP) - kati tipik</u>
CP1: 150 m ²	AP1: 100 m ²
CP2: 120 m ²	AP2: 90 m ²
CP3: 80 m ²	AP3: 80 m ²
CP4: 60 m ²	AP4: 70 m ²
-----	-----
<u>Gjithsej: 410 m²</u>	<u>Gjithsej: 340 m² * 5 = 1,700 m²</u>
- <u>Sipërfaqja totale e të gjitha 24 njësive:</u>	410 m ² + 1,700 m ² = <u>2,110 m²</u>

1.3 Inputet – Konsumi mujor i ngrohjes (energjisë termike).

<u>Konsumi i ngrohjes i CP-ve:</u>	<u>Konsumi i ngrohjes i AP-ve - kati tipik</u>
CP1: 2500 kWh	AP1: 1,400 kWh
CP2: 2050 kWh	AP2: 1,250 kWh
CP3: 1350 kWh	AP3: 1,100 kWh
CP4: 1050 kWh	AP4: 950 kWh
-----	-----
<u>Gjithsej: 6,950 kWh</u>	<u>Gjithsej: 5 * 4,700 kWh = 23,500kWh</u>
- <u>Konsumi total i ngrohjes i të gjitha njësive:</u>	6,950 kWh + 23,500 kWh = <u>30,450 kWh</u>
- <u>Konsumi total i ngrohjes së ndërtesës:</u>	<u>37,200 kWh</u>

2. Bilanci i nxehtësisë së ndërtesës me shumë njësi - Llogaritja e konsumit të përbashkët të ngrohjes së ndërtesës

2.1 Përdoret formula e bilancit të konsumit të ngrohjes së ndërtesës:

$$(1) \quad BHC_{MS-L} = \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L} + CHC_{NM}$$

2.2 Konsumi mujor i ngrohjes i të gjithë ndërtesës kolektive (nga leximi i njehsorit të nënstacionit të ndërtesës):

$$BHC_{MS-L} = 37,200 \text{ kWh}$$

2.3 Konsumi mujor i nxehtësisë i të gjitha njësive (nga matjet në nivel të njësive):

$$\sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L} = 30,450 \text{ kWh}$$

Shënim për 2.3:

Për arsye thjeshtësie, për shembull, llogaritja, konsumi i tërësishëm i njësive është parashikuar pavarësisht nga lloji i pajisjes matëse në nivel të njësive - HCA ose UHM; përndryshe llogaritja ndryshon paksa sipas llojit të pajisjes matëse të përdorur në nivel të njësive:

- Kur përdoret HCA:

Hapi i parë: Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjithë radiatorët e çdo njësie llogaritet duke përmblodhur nxehtësinë e transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësive, sipas formulës (2) të Metodologjisë:

$$(2) \quad UHC_{MU-L(HCA)} = \sum_{i=1}^r HTR_i$$

Hapi i dytë: Konsumi i ngrohjes i të gjitha njësive të ndërtesës llogaritet si shuma e konsumit të ngrohjes së secilës njësi, sipas formulës (3):

$$(3) \quad \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L(HCA)} = U_1 HC_{MU-L(HCA)} + U_2 HC_{MU-L(HCA)} + \dots + U_{24} HC_{MU-L(HCA)}$$

- Kur përdoret UHM individuale:

Hapi i parë: Leximet e njehsorit të konsumit të ngrohjes së njësisë ($UHC_{MU-L(UHM)}$) nga UHM-të e çdo apartamenti

Hapi i dytë: Llogaritja e konsumit të ngrohjes së tërësishëm të të gjitha njësive duke përmbledhur konsumin e matur të ngrohjes për çdo njësi, sipas formulës (4):

$$(4) \quad \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L(UHM)} = U_1 HC_{MU-L(UHM)} + U_2 HC_{MU-L(UHM)} + \dots + U_{24} HC_{MU-L(UHM)}$$

2.4 Konsumi mujor i ngrohjes i hapësirave të përbashkëta të ndërtesës ('Konsumimi i përbashkët i ngrohjes' - CHC_{NM}), nuk matet por rrjedh nga formula (1):

$$(5) \quad CHC_{NM} = BHC_{MS-L} - \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L}$$

$$\underline{CHC_{NM}} = 37,200 \text{ kWh} - 30,450 \text{ kWh} = \underline{6,750 \text{ kWh}}$$

3. Alokimi i konsumit të përbashkët të ngrohjes së ndërtesës në njësinë e mostrës

Konsumi i përbashkët i nxehtësisë i një ndërtese kolektive u shpërndahet njësive të ndërtesës në përpjesëtim me sipërfaqen e ngrohur të secilës njësi.

3.1 Njësia e mostrës 'U₃' (Apartament - 'AP3') - inputet për seksionin '3' të shembullit:

- Sipërfaqja U₃: $U_3 A = 80 \text{ m}^2$
- Sipërfaqja totale e të gjitha 24 njësive: $\sum_{i=1}^{24} U_i A = 2,110 \text{ m}^2$
- Konsumi i përbashkët mujor i ngrohjes së ndërtesës (siç llogaritet nën 2.4): $CHC_{NM} = 6,750 \text{ kWh}$

3.2 Së pari, koeficienti i alokimit të sipërfaqes llogaritet për njësi të caktuar sipas formulës (6):

$$(6) \quad k_{UAA} = \frac{U_3 A}{\sum_{i=1}^{24} U_i A}$$

$$k_{UAA} = \frac{80 \text{ m}^2}{2,110 \text{ m}^2} = 0,038$$

1.3 Pjesa e njësisë e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të ndërtesës i ndahet njësisë U_3 , sipas formulës (7):

$$(7) \quad US_{CHC} = k_{UAA} * CHC_{NM}$$

$$U_3 S_{CHC} = 0.038 * 6,750 = 255.924 \text{ kWh} \cong 256 \text{ kWh}$$

4. Llogaritja e faturës mujore të ngrohjes për konsumatorin – pronarin e njësisë ' U_3 '

4.1 Njësia e mostrës ' U_3 ' - inputet për seksionin '4' të shembullit

- Kapaciteti i nxehtësisë (termik) i njësisë U_3 : $HCU_3 = 7.5 \text{ kW}$
- Konsumi mujorë i ngrohjes (energjisë termike) i njësisë U_3 $U_3 HC = 1,100 \text{ kWh}$
- Tarifa e kapacitetit të nxehtësisë (termike). $HCT = 0.78 \text{ €/kW në muaj}$
- Tarifa e konsumit të energjisë termike (nxehtësisë). $TET = 36.25 \text{ €/MWh} = 0.03625 \text{ €/kWh}$

/Tarifat e mësipërme të përcaktuara nga ZRRE për NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2020/2021/

4.2 Ngarkesa (pagesa) për kapacitetin termik (TCC) llogaritet sipas formulës (8):

$$(8) \quad TCC = HCU_3 * HCT$$

$$TCC = 7.5 \text{ kW} * 0.78 \text{ €/kW} = 5.85 \text{ € në muaj}$$

- Komponent fiks që është nuk varet nga konsumi i ngrohjes së njësisë i matur në nivelin e njësisë

4.3 Ngarkesa (pagesa) për pjesën e njësisë në 'konsumin e përbashkët të ngrohjes' (CUS_{CHC}) llogaritet sipas formulës (9):

$$(9) \quad CUS_{CHC} = U_3 S_{CHC} * TET$$

$$CUS_{CHC} = 256 \text{ kWh} * 0.03625 \text{ €/kWh} = 9.28 \text{ €}$$

- Komponent fiks që është pavarësisht nga konsumi i ngrohjes së njësisë i matur në nivelin e njësisë

4.4 Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (energjisë termike) (HCC) e matur në nivelin e njësisë llogaritet sipas formulës (10):

(10) $HCC = U_3 HC_{MU-L} * TET$

$HCC = 1.100 \text{ kWh} * 0.03625 \text{ €/kWh} = 39.88 \text{ €}$ - Komponent variabël që pasqyron konsumin e matur në nivel të njësisë

4.5 Fatura totale mujore e ngrohjes për njësinë U_3 (pa TVSH) do të jetë:

Fat. totale = 5.85 + 9.28 + 39.88 = 55.01 €

